



4 European  
Union  
Kosovo

# Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike

Mungesa e një qasje sektoriale



Dhjetor 2020

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE 

# Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike Mungesa e një qasje sektoriale

Dhjetor 2020

## Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

## Përmbajtja

**3** Përmbledhje ekzekutive

**4** Hyrje


**5** Programi për rimëkëmbje ekonomike

**8** Performanca e industrive ekonomike

**10** Masat stabilizuese për ekonomi

**11** Përfundimet dhe rekomandimet

**12** Aneks



## Përmbledhje ekzekutive

Pandemia COVID-19 ka goditur në mënyrë jo-proporcionale industri të ndryshme të ekonomisë në Kosovë. Meqë vendimet e Qeverisë së Kosovës për kufizim të aktivitetit biznesor dhe lëvizjes së qytetarëve të cilat ishin marrë për të parandaluar përhapjen e virusit nuk janë të njëjta për secilën industri, rrjedhimisht edhe efektet ekonomike dallojnë. Të dhënat e fundit nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) tregojnë se aktivitetet ekonomike me rënien më të lartë të deklarimit të qarkullimit janë industria e arteve, argëtimit dhe rekreacionit (79%), patundshmëria (44%), transporti dhe magazinimi (43%) dhe akomodimi dhe shërbimi ushqimor (37%). Në anën tjetër, informimi dhe komunikimi kishte ngritje për 12%, uji, menaxhimi i mbeturinave 23% ndërsa industritë e tjera patën rënie relativisht të lehtë si ajo përpunuese me 6%, bujqësia 3% dhe tregtia 9%.

Më 14 tetor, ministrja e financave, znj. Bajrami kishte deklaruar se deri në atë periudhë ja ndarë 197 milionë euro nga pako e rimëkëmbjes ekonomike, pa specifikuar se për cilat masa bëhet fjalë. Ndonëse deri më tani, vendimet e qeverisë Hoti në kuadër të pakos së rimëkëmbjes ekonomike kapin vlerën prej rreth 109 milionë euro. Dallimi në këto dy shifra mund të qëndroj në atë se Qeveria Hoti ka ekzekutuar mjetet edhe për disa masa që lidhen me pakon emergjente, për të cilat vetëm se kanë ekzistuar vendime të mëhershme. Nga 109 milionë euro, janë tri vendime që përfshijnë mbështetje financiare të bizneseve. Në fillim të tetorit, qeveria shpërndau 60 milionë euro për të gjitha bizneset aktive, në bazë të numrit të punëtorëve të regjistruar dhe jo në bazë të performancës së industrisë. Ndihma për një punonjës, pavarësisht industrisë, ishte uniforme prej 290 euro. Ndërsa, më 30 nëntor 2020, nga Ministria e Zhvillimit Rajonal janë ekzekutuar edhe grantet për 156 biznese në vlerë totale 2 milionë euro për biznese mikro dhe të vogla. Mbështetja financiare e realizuar deri më tani nga qeveria për bizneset është e pamjaftueshme, marrë parasysh dëmin që u është shkaktuar atyre nga pandemia. Për më shumë, problematik është edhe fakti që sidomos tek ndihma në linjën e pagave prej 60 milionë euro, bizneset dhe industritë që janë ndikuar më rëndë, nuk janë ndihmuar proporcionalisht me humbjet që kanë pësuar. Ndërsa në sektorin e bujqësisë, janë dyfishuar subvencionet për përfituesit e përzgjedhur në fillim të vitit. Meqë rënia e kësaj industrie gjatë pandemisë ishte e ulët (3%), ndihmesa nga qeveria del të jetë më adekuate krahasuar me industritë tjera, ndonëse edhe në këtë rast ndihmesa është bërë në mënyrë proporcionale, pa ndjekur ndonjë kriter që shpërfaq se sa janë ndikuar nga pandemia kultura të ndryshme bujqësore.

Krahas masave për ndihmë të përgjithshme ndaj biznesve, është e rëndësishme që masat vijuese, sikurse ato në pakon e parapare për vitin 2021, të targetojnë industritë që kanë rënie më të lartë. Konkretisht, që shpërndarja e fondeve të jetë proporcionale me dëmin që kanë pësuar industritë.

## Hyrje

Pasi Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) vlerësoi në mars të vitit 2020 se sëmundja e shkaktuar nga virusi COVID-19 po kalon në nivele pandemie, shumë shtete panë të arsyeshme të ndërmarrin masa kufizuese ndaj lëvizjes së qytetarëve me qëllim parandalimin e përhapjes së shpejtë të virusit. Pas paraqitjes së rastit të parë me koronavirus në Kosovë, më 13 mars 2020, Qeveria e Kosovës vendosi t'i mbyllë të gjitha shërbimet e gastronomisë, qendrat tregtare, tregjet, dhe pezulloi aktivitetet kulturore dhe sportive për një periudhë të pacaktuar.<sup>1</sup> Dhjetë ditë më pas, në mbledhjen e 15-të, qeveria gjithashtu kufizoi edhe lëvizjen e qytetarëve në vetëm një orar të shkurtër gjatë ditës.<sup>2</sup> Kufizimi i industrive të tilla si dhe i konsumatorëve shkaktoi rënie të drejtëpërdrejtë në të hyrat e bizneseve të prekura.<sup>3</sup>

Megjithatë, për shkak që situata epidemiologjike në vend filloi të stabilizohet gradualisht, në prill 2020, Qeveria e Kosovës planifikoi të ndërmerr një sërë masash lehtësuese për biznese dhe qytetarë.<sup>4</sup> Fillimisht, nga 4 maji, qeveria lejoi pjesërisht hapjen e industrive të caktuara si për shembull ndërtimtarinë dhe tregtinë me pakicë. Nga 18 maji u hapën plotësisht tregtia me pakicë, ordinancat stomatologjike dhe shërbimet fizioterapeutike, tregjet e gjelbëra, etj. Ndërsa nga 2 qershori, ekonomia e Kosovës filloi revitalizimin falë hapjes së plotë të shumë industrive përfshirë edhe gastronominë në përgjithësi.

Mirëpo, edhe pse gjendja epidemiologjike e asaj kohe justifikoi masat lehtësuese, qeveria e pa të arsyeshme të vendosë masa të reja kufizuese në momentin kur u përkeqësua situata. Për shembull, më 5 korrik 2020, qeveria urdhëroi që bizneset që ofrojnë shërbime të gastronomisë të operojnë me kapacitete të zvogëluara (vetëm në hapësira jashtë) dhe gjatë orarit 21:00 – 05:00 të mbyllen totalisht,<sup>5</sup> dhe tetë ditë më vonë u urdhëruan edhe qendrat tregtare të mbyllen në ora 21:00 si dhe u pezulluan tregjet publike.<sup>6</sup> Qeveria vazhdoi të ndryshojë dhe plotësojë masat kufizuese ndaj bizneseve duke lehtësuar apo shtrënguar ato varësisht prej situatës epidemiologjike, dhe në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2020 vendosi një sërë masash kufizuese të reja për qytetarë sikurse edhe për biznese varësisht prej nivelit të rrezikshmërisë së komunës ku gjenden. Nga 13 nëntori, në komunat që u klasifikuan me rrezik të ulët, operatorët ekonomik lejohen të punojnë vetëm nga ora 05:00 deri 20:00, ndërsa shërbimet e gastronomisë dhe hotelierisë lejohen të punojnë pas atij orari përmes shërbimeve “merr me vete” apo me dërgesa. Në komunat të cilat u klasifikuan me rrezik të mesëm, orari i operimit të plotë i operatorëve ekonomik u zvogëlua në 05:00 – 18:00, ndërsa në komunat të cilat u klasifikuan me rrezik të lartë, orari i operimit të operatorëve ekonomik u lejua vetëm në periudhën 05:00-19:00.<sup>7</sup>

Të gjitha këto kufizime bënë që të hyrat e shumë industrive të bien dukshëm. Në bazë të të dhënave nga ATK, në nëntë-mujorin e parë të vitit 2020, u deklaruan mbi një miliardë euro më pak të hyra se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Përveç asaj, për shkak të kufizimeve në udhëtime ndërkombëtare, që shkaktuan edhe një rënie të vizitave nga diaspora e Kosovës, ekonomia e Kosovës vlerësohet

1 Qeveria e Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 9. Burimi: <https://bit.ly/37yuySa>

2 Qeveria e Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 15. Burimi: <https://bit.ly/39wxllP>

3 Instituti GAP, “Ndikimi i pandemisë COVID-19 në ekonominë e Kosovës,” Tetor 2020. Burimi: <https://bit.ly/33uEoTS>

4 Ministria e Shëndetësisë, “Adresimi i Ministrisë Arben Vitia para mediave, për masat e reja për Covid-19,” 30 prill 2020. Burimi: <https://bit.ly/33wrzIP>

5 Qeveria e Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 10. Burimi: <https://bit.ly/3lurfRo>

6 Qeveria e Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 13. Burimi: <https://bit.ly/2VnEtVe>

7 Qeveria e Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 42. Burimi: <https://bit.ly/2Vlypwl>

të ketë humbur prej 205 deri në 291 milionë euro krahasuar me vitin 2019 si pasojë e krizës së ulët.<sup>8</sup>

Në anën tjetër, programi për rimëkëmbje ekonomike në vlerë prej 365 milionë euro i miratuar nga Qeveria e Kosovës më 13 gusht 2020, ofron lehtësime në aspektet financiare dhe ligjore për biznese të prekura nga pandemia. Më konkretisht, 15 milionë euro janë ndarë për lehtësim të barrës tatimore për biznese dhe për të përmirësuar likuiditetin e tyre afatshkurtër, ndërsa 67.3 milionë i takojnë bizneseve për subvencionim të pagave të punëtorëve të tanishëm dhe mundësi të reja punësimi.<sup>9</sup> Megjithatë, Programi nuk cakton se sa do t'i mbështetë industrinë më të dëmtuar, gjë që vë në dyshim nëse do të ketë ndihmë proporcionale me dëmin e shkaktuar në industri të caktuara.

Andaj, qëllimi i këtij studimi është që të paraqesë dëmin që i është bërë ekonomisë së Kosovës në bazë të industrive të caktuara duke shikuar vendimet e qeverisë për kufizimin e aktivitetit biznesor dhe të lëvizjes, performancën e këtyre industrive gjatë vitit të tanishëm krahasuar me vitet e kaluara, dhe duke vlerësuar reagimin konkret të qeverisë në lidhje me këto industri. Për realizimin e këtij studimi janë përdorur të dhëna primare për qarkullim dhe punësim të industrive nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe të dhëna tjera mbështetëse.

## Programi për rimëkëmbje ekonomike

Me datën 13 gusht 2020, Qeveria e Kosovës aprovoi Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike<sup>10</sup> me vlerë prej 365 milionë euro përmes së cilës synohej të ndihmohej ekonomia nga dëmi që po e shkakton pandemia COVID-19. Ky program ishte përfshirë edhe në Ligjin e rishikuar të buxhetit për vitin 2020 të votuar me 30 korrik 2020.<sup>11</sup> Disa nga 15 masat e këtij Programi, që lidhen me mbulueshmërinë e kredive, subvencionimin e bizneseve të prekura nga pandemia dhe bujqësisë, kanë si pikënisje edhe Programin Qeverisës 2020-2023.<sup>12</sup> Ndërsa, disa masa tjera të këtij programi janë të bartura nga Pako Emergjente Fiskale, të cilat nuk kanë mundur të ekzekutohen me kohë për shkak të mungesës së buxhetit. Po ashtu, implementimi i masave të pakos së rimëkëmbjes nuk kishte filluar menjëherë pas votimit të saj në qeveri për shkak se disa nga masat ishin të përgjithësuara, duhej kohë për përgatitjen nën-masave, aktivitetëve dhe kritereve për implementimin e tyre, si dhe disa nga masat lidhur me rritjen e garancive kreditore nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe ridestinim të fondeve të AKP nëpër kategori të ndryshme ekonomike ishin të lidhura më Projektligjin për Rimëkëmbje.

Më 4 dhjetor 2020, Kuvendi i Kosovës miratoi edhe Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike me 13 amandamente të propozuara nëpër komisione dhe gjatë seancës së jashtëzakonshme.<sup>13</sup> Miratimi i këtij ligji ka kosto të numërta direkte dhe indirekte buxhetore. Por, më me ndikim do të jenë ato për subvencionim të bizneseve me fond prej 200 milionë euro dhe mbulesa e tre pagave për qytetarët e larguar nga puna gjatë pandemisë.

Deri në nëntor, Qeveria Hoti ka marrë vendime që lejojnë ndarjen dhe ekzekutimin e mjeteve që ndërlidhen me masat e rimëkëmbjes ekonomike në vlerë prej 108.6 milionë euro. Kurse, gjatë raportimit në komisionin parlamentar për buxhet dhe

8 Instituti GAP, "Ndikimi i diasporës në ekonominë e Kosovës gjatë pandemisë COVID-19," Nëntor 2020.

Burimi: <https://bit.ly/3obOrFl>

9 Qeveria e Kosovës, Vendimet e mbledhjes nr. 23. Burimi: <https://bit.ly/33CIHg3>

10 Ibid.

11 Kuvendi i Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/2VQBQw>

12 Qeveria e Kosovës. Programi Qeverisës 2020-2023. Burimi: <https://bit.ly/37waNLk>

13 Kuvendi i Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/39Mxpty>

transfere, ministrja e financave, znj. Bajrami kishte deklaruar së shuma e ndarë deri më 14 tetor në kuadër të rimëkëmbjes ekonomike rreth 197 milionë euro.<sup>14</sup> Në këtë shifër mund të hyjnë edhe mjetet që Qeveria Hoti mund të ketë ndarë për përfundimin e masave të pakos emergjente fiskale për të cilat veçse kishte vendime të mëhershme qeveritare. Në shumën prej 108.6 milionë euro nuk përfshihen edhe shtesat e ekzekutuara gjatë muajit nëntor për stafin mjekësor të angazhuar gjatë pandemisë me qëllim për të njëjtat mungojnë të dhënat.

Fillimisht, qeveria kishte ndarë gjatë muajit gusht rreth dhjetë milionë euro për mbarëvajtjen e mësimit gjatë pandemisë. Më pas, në shtator ishin ndarë rreth rreth 201 mijë euro për mbulimin e pagesës së sigurimit në kufi për diasporën kosovare që kishin hyrë me vettura në Kosovë gjatë muajit gusht, dy milionë euro për masat dhe aktivitetet për mbështetje financiare të grave të prekura nga pandemia, 12 milionë euro për dyfishimin e pagesave direkte në bujqësi, 2 milionë euro për përkrahje të bizneseve të prekura nga pandemia, 60 milionë euro për subvencionim të linjës së pagave dhe 7.5 milionë euro për dyfishim të asistencës sociale për muajt tetor-dhjetor. Kurse, në muajin nëntor, qeveria ka ndarë një milion euro për ndërmarrjen publike Trepça. Kurse gjatë tetorit, qeveria ka ndarë për shpenzim edhe nga dy milionë euro për mbështetje financiare të komuniteteve jo-shumicë. Ndërsa, më 30 nëntor 2020, nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, në kuadër të Masës 8 janë ekzekutuar edhe grantet për 156 biznese mikro dhe të vogla më vlerë totale 2 milionë euro.<sup>15</sup>

Mirëpo, jo të gjitha këto mjete të ndara nga qeveria ishin ekzekutuar menjëherë nga institucionet relevante. Masa për mbështetje financiare të grave është ende në proces, ku nga dy milionë euro buxhet janë ekzekutuar vetëm një milion euro. Ngjashëm, edhe për Masën 8, edhe pse plani për implementimin e saj është miratuar nga qeveria në shtator, koha e aplikimit dhe përzgjedhjes së bizneseve fituese ka marrë kohë deri në fund të nëntorit. Derisa, për rreth 255 milionë euro të pakos së rimëkëmbjes ekonomike mungojnë vendimet e qeverisë që ndajnë buxhetin për implementimin e masave.

Në vendimet për ndarjen e mjeteve financiare vërehet një devijim nga masat origjinale të aprovuara si pjesë e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, konkretisht zëvendësim i tyre me masa tjera të natyrës së njëjtë. Përderisa në programin për rimëkëmbje ekonomike parashihej një formë dhe shumë tjetër për subvencionim të pagave, qeveria më vonë ka vendosur për subvencionim të nga një page prej 290 euro për secilin punonjës të regjistruar. Po ashtu, mbetet e paqartë se deri në çfarë shume, pakoja e rimëkëmbjes ekonomike prej 365 milionë euro përfshin realizim të masave të Pakos Emergjente Fiskale. Masa 14 potencon se 72 nga 365 milionë euro parashihen për kompletimin e Pakos Emergjente<sup>16</sup>, mirëpo nuk është e qartë nëse buxheti për përfundimin e Pakos Emergjente është shpërndarë edhe tek disa masa tjera në Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike. Por siç tregon Tabela 1, deri në dhjetor të vitit 2020 nuk është marrë asnjë vendim nga qeveria për ekzekutimin e masës 14.

<sup>14</sup> Koha.net. Burimi: <https://bit.ly/2KujXjf>

<sup>15</sup> Shih përshkrimin e masës 8 në Aneks.

<sup>16</sup> Shih përshkrimin e masës 14 në Aneks.

**Tabela 1. Realizimi i Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike (365 milionë euro)**

Vendimi i Qeverisë	Masa	Shuma (Euro)	Përshkrimi
Nr. 01 /27	11	9,926,959€	Aprovimi i master planit për zhvillimin e mësimin në kushte pandemie 2020-2021
Nr. 09/31	13	200,954€	Primi bruto sigurim-gusht, mbulimi i sigurimit për diasporën
Nr. 02/33	10	2,000,000€	Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë përmirsimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi
Nr. 03/33	4A nga Pako, por masa 1.3 nga vendimi i ri	12,000,000€	Dyfishim i pagesave direkte në bujqësi
Nr. 10/33	Vendimi i ri, masa 1.1	60,000,000€	Subvencionimi i linjës së pagave për bizneset
Nr. 10/33	Vendimi i ri, masa 1.2	7,500,000€	Dyfishim i asistencës sociale tetor- dhjetor 2020
Nr. 13/33	8	2,000,000€	Mbështetje për programet ekzistuese dhe të reja të cilat lidhen me zhvillimin rajonal të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal
Nr.06/34	9	1,000,000€	Përmirësimi i jetës së komuniteteve jo-shumicë dhe rimëkëmbja e tyre ekonomike
Nr.10/34	-	13,000,000€	Per zbatimin e masave per rimëkembje ekonomike - kategoria subvencione dhe transfere.
Nr.18/38	Masa 15	-	Shtesa për mjekët, infermierët (shtator 2020 - dhjetor 2020) dhe stafin mbështetës (korrik 2020 - dhjetor 2020)
Nr.01/44	Masa 6C	1,000,000€	Për mbështetjen e N.P. "Trepça"
<b>Total</b>		<b>108,627,913€</b>	

Burimi: Qeveria e Kosovës

Shënim: Mbledhja e të dhënave për këtë punim ka përfunduar me 4 dhejtor 2020.

Miratimi i Ligjit të Rimëkëmbjes Ekonomike i mundëson qeverisë që të shfrytëzojë 100 milionë euro nga të hyrat prej Agjencisë Kosovare të Privatizimit për subvencione dhe transfere ose mallra dhe shërbime. Po ashtu, mund të fillojë tërheqja e 10% të kursimeve nga qytetarët nga Trusti pensional. Ngjashëm, në kuadër të Ligjit të Rimëkëmbjes disa biznese nga sektorë të caktuar mund të përfitojnë mënjëherë, sikurse sektori i gastronomisë nga ulja e TVSH-së për furnizim, sektori i aktiviteteve minerare nga falja e rentës minerare për një periudhë të caktuar, faljet e interesit dhe gjobave tatimore për të gjitha bizneset për një periudhë të caktuar nëse përmbushen disa kushte, ulja e kostos së energjisë elektrike për të gjithë qytetarët dhe bizneset si rrjedhojë e mbulimit të energjisë elektrike të prodhuar nga BRE-të nga qeveria, dhe më shumë. Ndërsa disa vendime tjera për ndihmesë të bizneseve dhe punëmarrësve të goditur nga pandemia, mund të marrin më shumë kohë që të implementohen për shkak të nevojës për gjetjen e burimit të financimit për këto masa dhe përpilimit të kriterëve për shpërndarjen e tyre.

## Performanca e industrive ekonomike

Ndikimi ekonomik i pandemisë ndryshon varësisht prej llojit të industrisë në Kosovë. Marrë parasysh që masat kufizuese shtetërore të parandalimit të shpërndarjes së virusit nuk janë të njëjta për secilën industri, rrjedhimisht edhe efektet ekonomike ndysojnë. Disa biznese që konsiderohen me potencial të lartë të shpërndarjes së virusit po qëndrojnë tërësisht të mbyllura ose kanë kufizime të hapësirës së funksionimit apo orarit të punës. Në anën tjetër, industri të tjera esenciale ekonomike kanë vazhduar punën përgjatë gjithë pandemisë.

Më 13 mars, Qeveria e Kosovës urdhëroi mbylljen e pothuajse tërë aktivitetit ekonomik me përjashtim të bizneseve esenciale si furnizimi me ushqim dhe produkte farmaceutike. Kjo periudhë vazhdoi deri më 18 maj kur filloi faza e hapjes graduale e ekonomisë. Megjithatë, disa biznese, si restorantet e dasmave, klubet e natës, palestrat sportive, pishinat e të tjera që hyjnë në industrinë e artit, argëtimit, rekreacionit, dhe veprimtarive shërbyese vazhduan të qëndrojnë të mbyllura ose operuan me orar të kufizuar.

Këto dallime të masave kufizuese ndaj bizneseve reflektohen edhe në performancën ekonomike të shpërfaqur në deklarin e qarkullimit në Administratën Tatimore të Kosovës. Aktivitetet ekonomike me rënie më të lartë të deklarin të qarkullimit janë industria e arteve, argëtimit dhe rekreacionit 79%, patundshmëria 44%, transporti dhe magazinimi 43%, akomodimi dhe shërbimi ushqimor 37%. Në anën tjetër, informimi dhe komunikimi kishte ngritje për 12%, uji, menaxhimi i mbeturinave 23% dhe industritë e tjera të cilat patën rënie relativisht të lehtë si ajo përpunuese me 6%, bujqësia 3% dhe tregtia 9%.

**Tabela 2. Ndryshimi i deklarin të qarkullimit nga industritë bazuar në tremujorë (TM) në milionë euro**

Industria	2019			2020			Ndryshimi në %*
	TM1	TM2	TM3	TM1	TM2	TM3	
Artet, argëtimi dhe rekreacioni	€17.55	€5.69	€7.26	€3.35	€0.78	€2.41	▼ -79%
Person fizik	€29.83	€31.02	€26.04	€6.15	€5.58	€9.96	▼ -75%
Aktivitetet e patundshmërisë	€7.55	€7.36	€8.72	€4.01	€3.95	€5.39	▼ -44%
Transporti dhe magazinimi	€77.59	€99.38	€123.9	€62.60	€42.98	€66.16	▼ -43%
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	€32.49	€36.66	€55.71	€2.45	€13.89	€32.90	▼ -37%
Shërbimet administrative e mbështetëse	€42.09	€52.47	€67.23	€37.51	€25.10	€45.27	▼ -33%
Aktivitetet e tjera shërbyese	€16.23	€19.62	€23.55	€15.59	€14.67	€17.16	▼ -20%
Ndërtimtaria	€159	€232.2	€280.4	€168.4	€144.7	€252.9	▼ -16%
Arsimi	€13.52	€13.15	€14.79	€12.84	€10.74	€12.57	▼ -13%
Tregtia, riparimi i mjeteve motorike	€1,196	€1,470	€1,700	€1,261	€1,172	€1,522	▼ -9%
Industria nxjerrëse	€28.16	€44.85	€51.46	€37.46	€43.89	€32.08	▼ -9%
Aktivitetet e shëndetit të njeriut, puna sociale	€17.44	€17.82	€19.64	€16.24	€13.59	€21.36	▼ -7%
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	€44.11	€54.35	€62.26	€41.01	€46.96	€62.92	▼ -6%
Industria përpunuese	€267.1	€374.4	€430.6	€275.1	€09.4	€423.2	▼ -6%
Admin. publik, mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm	€5.57	€5.31	€5.65	€5.36	€4.51	€5.82	▼ -5%
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	€104	€120.3	€129.6	€109.4	€108.7	€119.6	▼ -5%
Bujqësia, pylltaria, peshkimi	€15.03	€19.30	€22.82	€16.43	€17.16	€21.85	▼ -3%
Furnizimi me rrymë, gaz, avull, AC	€207.7	€171.4	€187.4	€226.3	€158	€167.1	▼ -3%
Informimi dhe komunikimi	€64.11	€66.20	€78.14	€73.60	€69.88	€89.89	▲ 12%
Ujë, kanalizim, menaxhim i mbeturinave	€15.56	€18.14	€16.50	€18.92	€20.40	€22.20	▲ 23%

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës<sup>7</sup>

\*Ndryshimi në përqindje merr për bazë periudhën nëntë-mujore (TM1-TM3) të vitit 2020 karahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.



Efektet ekonomike ndërmjet industrive ndyshojnë edhe sa i përket punësimit. Aktivitetet ekonomike që janë përballur me më pak kufizime në operim kanë deklaruar më pak rënie të punësimit për dallim nga industritë e tjera. Në tabelën 3 shihet se numri i punëtorëve në industritë si artet, argëtimi dhe rekreacioni u reduktuan për 83%, transporti dhe magazinimi për 41%, aktivitetet e patundshmërisë për 23% dhe aktivitetet e tjera shërbyese për 13%. Në ndërkohë industritë përpunuese, të ujit, menaxhimi i mbeturinave, dhe industria nxjerrëse kishin ngritje të të punësuarve gjatë periudhes së pandemisë.

Ekziston një ndërlidhshmëri e lartë në mes të masave kufizuese dhe performancës ekonomike. Si në deklarin e qarkullimit, ashtu edhe në punësim vërehet se industritë të cilat kanë qenë të mbyllura ose kanë operuar pjesërisht kanë deklaruar aktivitet më të ulët ekonomik e rrjedhimisht edhe punësim. Ky efekt mund të shihet edhe sa i përket tremujorëve. Në periudha të caktuara kur janë relaksuar masat kufizuese të disa industrive ka filluar edhe ngritja e deklarin të qarkullimit.

**Tabela 3. Ndryshimi i deklarin të punësimit nga industritë bazuar në tremujorë (TM)**

Industria	2019			2020			Ndryshimi në %*
	TM1	TM2	TM3	TM1	TM2	TM3	
Person Fizik	10,254	8,251	5,863	1,351	1,243	1,636	▼ -83%
Artet, Argëtimi dhe rekreacioni	7,925	5,400	5,319	4,413	3,001	3,577	▼ -41%
Transporti dhe magazinimi	30,807	31,532	32,248	22,287	20,925	24,337	▼ -29%
Aktivitetet e patundshmërisë	1,892	1,969	1,927	1,500	1,330	1,641	▼ -23%
Bujqësia, pylltaria, peshkimi	9,612	10,747	10,723	8,906	8,637	9,321	▼ -14%
Aktivitetet e tjera shërbyese	35,292	37,908	37,064	30,651	31,548	33,454	▼ -13%
Akti. e shëndetit të njeriut dhe punës sociale	16,781	17,387	17,575	16,921	14,098	16,734	▼ -8%
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	27,676	29,071	29,873	27,724	26,358	29,710	▼ -3%
Tregtia, riparimi i mjeteve motorike	205,328	210,170	216,430	206,031	194,243	213,929	▼ -3%
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	46,670	48,468	50,769	47,166	47,100	48,979	▼ -2%
Arsimi	17,809	18,487	15,637	19,613	15,974	15,653	▼ -1%
Admin. publik, mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm	253,814	257,116	257,675	258,730	257,293	256,125	0%
Furnizimi me rrymë, gaz, avull, AC	23,520	23,263	23,586	24,085	23,629	23,550	▲ 1%
Ndërtimtaria	53,455	63,242	63,810	55,265	61,525	70,129	▲ 4%
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	38,060	39,952	44,151	46,091	36,957	47,830	▲ 7%
Industria përpunuese	87,704	94,254	97,078	98,232	97,591	108,733	▲ 9%
Sherbimet administrative dhe mbështetëse	22,738	23,487	24,824	26,819	25,367	28,317	▲ 13%
Industria nxjerrëse	13,516	14,152	14,515	14,506	15,408	18,456	▲ 15%
Informimi dhe komunikimi	29,376	30,026	30,396	38,593	36,470	38,914	▲ 27%
Ujë, kanalizim, menaxhim i mbeturinave	9,029	9,243	9,264	15,868	16,042	16,084	▲ 74%

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës<sup>8</sup>

\*Ndryshimi në përqindje merr për bazë periudhën nëntë-mujore (TM1-TM3) të vitit 2020 karhasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

## Masat stabilizuese për ekonomi

Përderisa ndikimi ekonomik vazhdon të jetë joproportional ndërmjet industrive, ndihmesat qeveritare deri më tani kanë qenë kryesisht të barabarta në të gjitha industritë dhe jo të targetuara në bazë të dëmit ekonomik. Masa mbështetëse e ndërmarrë nga qeveria me vlerë prej 60 milionë euro dhe më e larta për sektorin privat është shpërndarë në bazë të numrit të punëtorëve të regjistruar dhe jo në bazë të performancës së industrisë. Për shembull, janë mbi 7,000 punonjës vetëm nga supermarketet në Kosovë<sup>19</sup>, për të cilët bizneset mund të përfitojnë nga subvencionimi i MF-së, ndonëse kjo kategori nuk është përballë me kufizimet të njëjta sikur kategoritë tjera biznesore sa i përket kohës së operimit. Ndërsa në rastin e dyfishimit të subvencioneve për bujqësi (pagesave direkte) për përfituesit e përzgjedhur në fillim të vitit, marrë parasysh dhe rëniën më të ulët të këtij sektori gjatë pandemisë (-3%), ndihmesa nga qeveria del të jetë më e mjaftueshme. Por edhe në këtë rast, ndihma nuk ka qenë proporcionale, dhe nuk ka paraparë kritere që masin se sa janë ndikuar nga rënia e kërkesës kultura të ndryshme bujqësore sikurse mielli, perimet, qumështi, dhe më shumë.

**Tabela 4. Përfituesit e masës për subvencionim të pagave nga MF sipas madhësisë së biznesit**

Rangu i punëtorëve	Numri i bizneseve	Subvencioni (€)	Numri i punëtorëve	% e Subvencionit
0-10	33,600	27,300,000	94,090	45.50%
11-50	2,701	16,000,000	55,162	26.67%
51-100	217	4,370,000	15,075	7.28%
101-200	102	4,170,000	14,390	6.95%
201-300	29	2,060,000	7,104	3.43%
Mbi 301	30	6,100,000	21,031	10.17%
<b>Total</b>	<b>36,679</b>	<b>60,000,000</b>	<b>206,852</b>	<b>100%</b>

Burimi: Ministria e Financave

Ndihmesa të tilla, ku nuk përcaktohen kritere të qarta që tregojnë se bizneset përfituese nuk janë në gjendje të mbulojnë obligimet ndaj punonjësve dhe shpenzimet operative, mund të inkuadrohen edhe në Ligjin për rimëkëmbje ekonomike sikurse në nenin 11 që parasheh 200 milionë euro për ndihmesë të bizneseve. Masa të tilla të barabarta thellojnë pabarazinë në mes industrive dhe vështirësojnë rimëkëmbjen e industrive më të prekura nga kufizimet qeveritare.

Në anën tjetër, disa vende të rajonit, gjatë intervenimit në ekonomi përmes politikave fiskale ofruan asistencë specifike për industri që pësuan më së shumti humbje nga pandemia. Maqedonia Veriore indentifikoi industrinë e turizmit, transportit dhe hotelierisë si industritë më të prekura nga masat kufizuese dhe si rezultat ndihmoi ato me politika të veçanta. Masa e parë që kishte për qëllim ndihmesën e sektorit privat për mbulimin e pagave, u përcaktua varësisht nga humbjet e të ardhurave të industrive duke filluar nga 240 euro deri në 350 euro.<sup>20</sup> Industritë më të prekura nga pandemia përfituan 350 euro për punëtorë ndërsa ato më pak të prekura 240 euro. Një masë tjetër ofroi kartela njëpërdorimëshe

<sup>19</sup> Shih Raportet Financiare të bizneseve në uebfaqen e MF. Burimi: <https://bit.ly/3n7DHro>.

<sup>20</sup> Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. Ekonomitë e Evropës Juglindore  
Burimi: <https://bit.ly/3lXAfyf>

të kredituara me 50 deri në 150 euro për familje me të ardhura të ulëta. Këto kartela ishin të destinuara të përdreshin vetëm në industrinë më të prekura nga pandemia si turizmi, prodhimet vendore, transporti dhe akomodimi. Kjo metodë e cila ndihmon personat me të ardhura të ulëta dhe bizneset që janë prekur më së shumti nga pandemia u përdor edhe nga vendet e tjera të rajonit, si Bosnia e Hercegovina dhe Serbia.

Maqedonia Veriore implementoi edhe masa të tjera të veçanta ndaj industrive më të prekura. Një tjetër masë ishte edhe granti për restorantet e dasmave të cilat u mbështetën me vlerë totale prej një milion euro. Për sektorin e tekstilit, qeveria financoi platformë dixhitale me vlerë prej një milion euro, ku kompanive u mundësohet të vendosin produktet e tyre për shitje online. Mbështetje shtesë ju ofrua industrisë së turizmit ku u lehtësua rimbursimi i klientëve që kishin paguar udhëtim gjatë krizës me vlerë prej 1.2 milionë euro.<sup>21</sup>

## Përfundimet dhe rekomandimet

Masat kufizuese të Qeverisë së Kosovës, të cilat ishin të vendosura shpejtë pas rasteve të para me koronavirus në Kosovë, limituan operimin e bizneseve të llojllojshme sikurse lëvizjen e qytetarëve. Mirëpo, edhe pse qysh në fillim u mbyllën shërbimet e gastronomisë apo aktivitetet kulturore, shërbimet esenciale si farmacitë apo vetëshërbimet, shërbimet publike si furnizimi me ujë, energji elektrike, menaxhim të mbeturinave dhe shërbime informimi dhe komunikimi u lejuan të qëndrojnë hapur. Me kalim të kohës, masat e qeverisë u shtrënguan apo u lehtësuan varësisht prej situatës epidemiologjike në Kosovë. Më konkretisht, bizneset të cilat cilësoheshin me rrezikshmëri më të lartë u përballën me masa më strikte sikurse kufizimi i orarit apo kapacitetit të operimit ose mbylljes totale.

Të dhënat e ATK-së tregojnë se ekziston një ndërlidhshmëri në mes masave kufizuese dhe performancës së industrive të caktuara. Industrinë që deklaruan rënie më të madhe të qarkullimit dhe punësimit janë artet, argëtimi dhe rekreacioni, aktivitetet e patundshëmrisë, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor. Njëkohësisht, këto janë industrinë që u përballën me masa më strikte.

Përderisa vendet në rajon kanë hartuar masa të veçanta për industrinë më të prekura nga kufizimet e operimit, ndihmesat e Qeverisë së Kosovës kanë qenë kryesisht uniforme në të gjithë industrinë ekonomike, përjashtuar ndihmesat për sektorin privat. Kjo qasje rrezikon që rimëkëmbja të vështirësohet te industrinë e rëndësishme dhe strategjike të vendit dhe andaj Instituti GAP rekomandon që Qeveria të merr parasysh industrinë që kanë rënie më të lartë dhe të i targetojë ato me fonde të cilat janë proporcionale me dëmin që kanë pësuar ato sikurse me politika që ndikojnë veçanërisht në rimëkëmbjen e tyre.

21 Ibid.

## Aneks

**Tabela 5. Masat në kuadër të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike**


Masa	Përshkrimi i masës	Buxheti
Masa 1	Lehtësimi i qasjes në kredi për ndërmarrje private për të financuar projekte investive dhe vazhdimin e operimit, në vlerë prej njëqind milion euro	100,000,000€
Masa 2	Lehtësimi i barrës tatimore të bizneseve, për të përmirësuar likuiditetin e tyre afatshkurtër	15,000,000€
Masa 3	Rritje e punësimit, në veçanti e grupeve specifike të punëtorëve me gjasa më të ulëta për punësim	67,300,000€
Masa 4	Rritje e prodhimit bujqësor vendor, për të rritur punësimin në zonat rurale, për të zvogëluar importin e produkteve bujqësore, për të tejkaluar sfidat nga mundësia e shitjeve, shkaktuar nga COVID-19, dhe për të rritur sigurinë e ushqimit	26,000,000€
Masa 5	Stimulimi i kërkesës agregate, e cila nxit prodhimin dhe punësimin me efekte multiplikuese në ekonomi	15,000,000€
Masa 6	Mbështetje e operimit dhe investimeve kapitale të ndërmarrjeve publike, në veçanti ato investime që janë të natyrës strategjike, që të përballojë uljen e të hyrave nga inkasimi dhe investimet e nevojshme kapitale	17,000,000 €
Masa 7	Mbështetje financiare për punësimin e të rinjve, përkrahjen e organizatave të shoqërisë civile, grupeve tjera jofomale, stimulimit të aktiviteteve kulturore, artistike, sportive dhe vitalizimit të tyre	5,000,000€
Masa 8	Mbështetje për programe ekzistuese dhe të reja që lidhen më zhvillimin rajonal përmes Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, që ndikojnë në zhvillimin të vanacuar rajonal	2,000,000€
Masa 9	Mbështetjeve komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës, për projektet dhe iniciativat që synojnë përmisimin e jetës dhe rigjallërimin ekonomik të tyre	2,000,000€
Masa 10	Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë përmisimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi	2,000,000€
Masa 11	Mbështetje e sektorit të arsimit për të mundësuar fillimin dhe mbarevajtjen me sukses të mesimit gjatë vitit shkollor 2020/2021	10,000,000€
Masa 12	Mbështetje për komunat e Kosovës për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19	10,000,000 €
Masa 13	Mbështetje financiare për bashkatdhetarët, duke mbuluar koston e primit të policisë së sigurimit	3,000,000€
Masa 14	Financimi (rimbursimi i linjave buxhetore) për zbatimin e masave të vendimit Nr.01/19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës	71,700,000€
Masa 15	Kontigjencë për emergjencë- Kontigjencë mbahet në raste emergjente për përballimin më të mirë të pandemisë COVID-19	19,000,000€







Projekti “Inovacioni për mediat e qëndrueshme dhe angazhimin qytetar” implementohet nga:

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE 

KOSOVO 2.0







European  
Union  
Kosovo